



**Qendra
"ASET"**

Qendra "ASET" promovon mbrojtjen e të drejtave të njeriut, drejtësinë dhe sigurinë sociale, paqen, zhvillimin territorial dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Programet e zhvillimit të Qendrës ASET synojnë të sigurojnë dinjitet dhe barazi, garantimin e të drejtave të personave duke zhvilluar çdo formë të solidaritetit social ndërmjet individëve, duke luftuar çdo formë të varfërisë, duke promovuar iniciativa kulturore, edukative si dhe asistencë ligjore, sociale e shëndetësore.

Qendra ASET është licensuar për ofrimin e Shërbimeve të Përkujdesit Komunitar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Gusht 2021



"Nuk je vetëm"

Kjo fletpalosje është publikuar në kuadër të projektit "Nuk je vetëm" i mbështetur financiarisht nga Bashkia Tiranë me qëllim ofrimin e asistencës shtëpiake për të moshuar në nevojë në Bashkinë Tiranë.

Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe gjetjet e paraqitura në të, janë përgjegjësi e Qendrës "ASET" dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkisë Tiranë.

www.asetcenter.al
+355 693113606
info@asetcenter.al



"Nuk je vetëm"

Asistencë shtëpiake për të moshuar



Asistencë shtëpiake për të moshuar në nevojë

Cfarë është asistencë shtëpiake?

Kujdesi në shtëpi iu ofrohet të gjithë të moshuarve dhe të rriturve me probleme paaftësie dhe/ose në gjendje të brishtë sociale-ekonomike, banorë të njësisë së qeverisjes vendore që siguron një shërbim të tillë, duke iu dhënë përparësi njerëzve të varfër ose me të ardhura të kufizuara, atyre që gjenden në situatë emergjence, në gjendje të plotë paaftësie ose të pjeshme, fizike ose mendore në plotësimin e nevojave të jetës së përditshme, të vetmuar ose me rrjete familjare / miqësore të dobta ose të papërshtatshme.

I moshuari në nevojë, personalisht ose përmes sinjalizimeve të familjes, të njohurve, mjekut të familjes, administratorit social të zonës, operatorëve socialë- shëndetësorë, ose të tjerë aktorëve të territorit, i drejtohet me një kërkesë për përfitim shërbimi Qendrës ASET.

Punonjësi social është personi përgjegjës për rastin. Ai rregullon qasjen e qytetarit të moshuar në rrjetin e shërbimeve sociale dhe social-shëndetësore, duke kryer vlerësimin profesional të nevojave dhe përcaktimin e rrugës për kujdes të personalizuar dhe zbatimit të tij në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit, duke siguruar menaxhimin dhe kontrollin e shërbimeve të ofruara në lidhje me objektivat.

Shërbimi i Asistencës Shtëpiake është një shërbim lëvizës apo një shërbim specifik që ofrohen në banesën e të moshuarit, i specializuar dhe i personalizuar sipas nevojave të të moshuarve. Ky shërbim përfshin:



- Shërbimi në familje/ asistencën në shtëpi, të personalizuar për të moshuar të paaftë për tu kujdesur për veten dhe ata që bëjnë jetesë të pavarur por që kanë nevoja të ndryshme, për shoqërim, për t'i ndihmuar në punët e shtëpisë, për t'i shoqëruar në takime dhe advokimin në emër të tyre sipas nevojës, përfshirë ndihmën ekonomike, shërbimet sociale, aksesin në strehim, kujdes shëndetësor, etj.
- Mbështetje psiko-sociale e cila sigurohet nga punonjësit socialë dhe psikologët sigurisht nëpërmjet vizitave në shtëpi dhe evidentimit të problematikave individuale.
- Ndërmjetësimi familjar për lidhjen me familjen (raste specifike).
- Programe për të trajtuar nevoja të veçanta si për shembull: të moshuarit me aftësi të kufizuara.